Në Qendrën e Mjekësisë Familjare dhe njësit e saj, në hyrje kanë vazduar të qëndrojnë ekipet për triazhimin e pacientëve. Obekti ndihmës apo Ambulanta COVID 19, ka vazduar të shërbuje si qendër për administrimin e terapisë parenterale për qytetarët e Obiliqit të infektuar me COVID 19 përgjat 24 orëve e cila në shfrytëzim ka 13 shtretër dhe 9 të tjera në dispozicion varsisht nga kërkesa dhe nevojat e të infektuarve. Nga ana e MSH është përforçuar stafi me një Mjek dhe një infermiere shtesë. Gjatë viti 2020 në komunën e Obiliqit u testuan 1626 qytetar, 783 rezultuan pozitiv me COVID – 19, Përderisa të shëruar I kemi 686 qytetarë, Prej tyre raste të vdekjes nga COVID-19 janë gjithsejt 28 qytetarë.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA:

- Ofrimin e shërbimeve shëndetësore 24/7 të personelit shëndetësor, QKMF-së, gjithmonë duke respektuar masat mbrojtëse individuale.
- Furnizim me barna dhe material shpenzues për QKMF dhe QMF dhe AMF
- Furnizim me pajisje mbrojtëse për punëtorët shëndetësorë në luftën kundër Covid 19
- Furnizim me inventar për nevojat e objekteve shëndetësore – KPSH
- Identifikimin e objektit për karantinë të grupeve, pacienteve që janë të dyshimt me Corona Virus, me qëllim të mos përzierjes me pacientë të tjera. Me qëllim të menaxhimit të situatës dhe rrezikut të mundshëm nga Corona Virusi në Komunën e Obiliqit mbylljet "Shtëpia e Pleqëve" si rezultat i rrezikshmërisë më të lartë që të moshuarit të atakohen nga Virusi Corona. Pas mbylljes së aktiviteteve në "Shtëpinë së Pleqëve" ky objekt caktohet si karantinë për rastet e infektura me COVID-19.
- Sigurimi i paisjeve mbrojtëse për personel shëndetësorë të QKMF-së dhe njësit e saj.
- Sigurimi i tetë (8) aparateve oksigjeni koncentrator, apo pajisje të cilat prodhojnë oksigjen me rrymë.
- Sigurimi i termometrave me rreze infra të kuqe.
- Veshmbathje komplet me syza mbrojtëse (të cilat komuna jonë i ka poseduar qysh moti dhe kemi qenë të gatshëm për të ndihmuar edhe komunat të cilat kanë pasur nevojë si; Lipjanin, Drenasin, Prishtinën, Vitinë, Ferizajin dhe Pejën).
- Formuam ekipet për monitorimin e situatës në teren, janë caktuar katër ekipe monitoruese.
- U ngrit niveli i higjenës dhe masave tjera profillaktike në bazë rekomandimeve të IKSHPS-së. Dezifikimi i QKMF-së duke përfshirë edhe autoambulancat, në vazhdimësi u dezinfektuan, në mënyrë që personeli shëndetësor dhe qytetarët që shërbehen të jenë sa më të sigurt.

Pavarsisht masave të marra, izolimi social është shumë i rëndësishëm në frenimin e përhapjes së infeksionit. Mënyra për të ndihmu personelin shëndetësorë dhe qytetarët për të përballu këtë situatë u kordinuan biseda telefonike pa pagesë dhe thirjet online, përmes viberit.

- Dezinfektimi u realizu në mënyrë të vazdueshme në objektet Komunale, QPS, dy objektet e OJQ-së Ballkan Sunfloëers me seli në Plemetin, Shtëpinë e Kulturës në Miloshevë, Shtëpinë e Penzionerave, objektin e Ambullantës së vjetër në Miloshevë, objektet Shëndetësore dhe të gjitha autoambulancat, QKRC, Stacioni Policor dhe veturat e tyre zyrtare, Enti i Punsimit, Banesat Kolektive në Plemetin dhe Obiliq, Barakat në Plemetin, Shkollat, Xhamite, Kishat, Shtëpia e Kulturës, Sallat Sportive, etj.
- Procesi i deratizimit (eliminimit të brejtësve) i rrjetit të kanalizimit, bodrumeve dhe objekteve publike nëpër lagjet e banesat kolektive u realizu poashtu.
- Vendosja një tendë në oborrin e QKMF-Obiliq me hapsir prej 30m².
- I gjithë personeli u njoftu me masa të cilat duhet të ndërmerrën në parandalimin e infeksionit me Corona Virus.
- Kemi vendosur njoftues, udhëzues mbi njohuritë për virusin në të gjitha Shkollat, Ambullanta, Shtëpi të Pleqve, Qendër për Punë Sociale, Qendra Rinore, Salla Sportive, Shtëpi të Kulturës, Qendrën për Punsim, Komunë etj.
- Stafi administrativ dhe teknik angazhohen me punë të tjera si: staf mbështetës për ekipe shëndetësore, vozitës, etj.
- Nga gjithsejt 5 autoambulanca dhe një pikap, dy nga to u dedikuani vetëm për bartjen e të infektuarve me virusin Corona.
- Në vijim të situatës së krijuar nga pandemia COVID19, ndihmë të të moshuarve mbi 65 vjeç, që nuk kanë familjar apo të afërt, personave me aftësi të kufizuar, të sëmurve kronik, u mudësohet me mjekun familjar dhe farmacistin ofrimi i medikamenteve dhe shërbimeve të tjera në shtëpi.
- Ekipe mbështetëse në Aeroportin e Prishtinës "ADEM JASHARI", të paisur me veshëmbathje komplete dhe termometra si dhe ekipe shëndetësore në mbështetje të kufirit në Elez Han. Kryetari i Komunës siguroi mbështetje logistike për këto ekipe (paisjet, veturën, ushqimin). Duke pas parasysh situatën epidemiologjike e cila merrte përmasa më të mëdha si dhe fluksin e madhë të udhëtarëve të kthyer nga vratat epidemike nga MSH rekomandohet të dyfishohen ekipet e QKMF-ve në hyrjet kufitare të Kosovës, si dhe personat që vinë nga vratat epidemiologjike të vetëkarantinohen. Me këtë rast dyfishohen ekipet tonë në Aeroport të Prishtinës ku dërgohet edhe epidemiologia e Komunës sonë. Gjithsej formohen tri ekipe mbështetëse nga Komuna e Obiliqit.
- Janë vendosur kapacitete të shtuara laboratorike.
- Paisja me mjete mbrojtëse në vazhdimsi e të gjithë pacientëve në Hemodializë.
- Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objektit QKMF-së;
- Furnizim me barna dhe material shëndetësor mjekësor;
- Furnizim me material administrativ shëndetësor;
- Përcaktim i stafit menaxhues për aktivitetin.
- Për testimin e rasteve të dyshuara për ndërprerjen e zingjirit të transmetimit të infeksionit fillon furnizimi me teste serologjike. Laboratori i QKMF-së kryen teste serologjike për virusin COVID 19 dhe është furnizuar me 5,700 teste për fazën e parë.
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësor edhe gjatë gjendjes emergjente, si pasojë e pandemisë globale.
- Gjatë kësaj periudhe kohore është kërkuar nga personeli shëndetësor ndërprerja e shfrytëzimit të pushimeve vjetore dhe rritja e kujdesit dhe kritereve për shfrytëzimin e pushimeve mjekësore.

- Me qëllim të reduktimit të lëvizjeve dhe ekspozimit të panevojshëm të pacientëve që vuajnë nga diabeti, ekipet mobile bënë shpërndarjen e insulinës në shtëpitë e insulinivartësve.
- Me qëllim të mbrojtjes së shëndet publik është vazhdu vaksinimi i fëmijëve të planifikuar dhe i nxënësve shkollorë ku u ndërmorrën të gjitha masat mbrojtëse.
- Përgatitje teknike rrëth vlerësimit të lëndëve rrëth subvencioneve shëndetësore.

Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj. Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF, Kryetarin e Komunës dhe Shtabin Emergjent Lokal në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë, në prioritet ndërmarrjen e masave preventive rrëth parandalimit të koronavirusit. Njoftim i vazhdueshëm rrëth riorganizimit të personelit shëndetësor mbi gatishmërinë e përhapjes së koronavirusit.

Të gjitha familjet e vetëizoluara dhe familjet në nevojë janë kontaktu nga këto ekipe, janë rekomandu për masat e vetëizolimit si dhe jan ndihmu me pako ushqimore dhe higjenike. U shpërndan mbi 6,000.00 pako ushqimore dhe higjenike për familjet në nevojë ku që ne fillim të Pandemisë, Kryetari i Komunës përmes Kuvendit Komunal ndan mjete buxhetore për sigurimin e 1200 pakove ushqimore dhe higjenike për familjet në nevojë, mjete për dezinfektimin e objekteve në mënyrë të vazhdueshme si dhe sigurimin e mjeteve mbrojtëse për ekipet shëndetësore në Komunën e Obiliqit.

Me aprovin e pjesëtarve të Shtabit Emergjent Komunal si dhe me aprovin e Asambleistëve Komunal u ndanë mjete në vlerë prej 100,000.00€.

Furnizimi me pako ushqimore dhe higjenike u realizu në vazhdimsi nga mjetët e komunës, organizatave, bizneseve dhe donatorve të shumt vendor dhe nga diaspora, organizatave joqeveritare: OJQ Ballkan Sunfloërs, USAID, IOM, Relief Islamik, Bashkësia islamë "Rahmeti", Duart e Bamirisë, Firdeus, UNICEF, Fondacioni Freskia, AQH, ROMACTED, UNDP, Qatar, Jetimat e Ballkanit, Organizata e Emirateve të Bashkuara Arabe në bashkëpunim me MPMS, UN, Kryqi i Kuq vendor, Viva Fresh, Rissi Com, Matkos Pharm, grup shokësh nga Prishtina dhe shumë të tjera.

Aplikimi për pakon fiskale Masa15. Në Komunën e Obiliqit kanë apliku gjithsej 808 aplikant. Nga ta 643 veta kanë apliku në mënyrë fizike dhe 165online. Faza e parë dhe e dytë e aplikimit ka përfundu me sukses. Pesë zyrtarët e QPS kanë punu në vazhdimsi, çdo ditë pune.

DSHMS në bazë të kompetencave që i dalin nga ligji nr.03/048, ligjit për shërbime sociale dhe familjare nr.02/L-17, Statutit të Komunës nr.01/34, konformë rregullorës nr.108, shpallë Thirrje Publike për blerjen e këtyre shërbimeve të veqanta:

- I. Shërbime sociale dhe familjare përfshirë pa përkujdesje prindërore
- II. Shërbime për personat me aftësi të kufizuar
- III. Shërbime për strehimin e viktimateve të dhunës në familje
- IV. Kujdesi Shëndetësor Ambulantor dhe Shtëpiak

Vlera totale për blerjen e këtyre shërbimeve të veçanta është 46,196.84€.

Gjatë vitit 2020 nga DSHMS janë inicu procedurat e prokurimit për projekte dhe shërbime tjera për nevojat e QKMF-së dhe QPS:

1-Renovimi I Objekteve të QKMF-së.....	38,000.00€
2-Paisje mjekësore për QKMF-në.....	20,000.00€
3-Inventar dhe rregullimi I oborrit AMF- Breznicë.....	40,000.00€
4-Mjete Mbrojtëse dhe Paisje për personel.....	15,000.00€
5-Furnizim me Kabina (Porta) për dezinfektim.....	2,500.00€
6- Dezinfektimi në Komunën e Obiliqit.....	15,000.00€
7- Furnizim me pako ushqimore dhe higjenike për Familjet në nevojë.....	60,000.00€
8-Dezinfektim, Deratizim,Dezinsektim.....	25,000.00€
9- Mjete mbrojtëse për COVID-19.....	34,000.00€
10- Laborator për analiza (COVID-19).....	15,000.00€
11- Teste Serologjike.....	132,000.00€
12- Pako ushqimore dhe higjenike për familjet në nevoj.....	15,000.00€
13- Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim.....	15,000.00€

RAPORTI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2020

MALLRA DHE SHERBIME	Zotimi	Të shpenzuara
Material gjinekologjik-radilogjik	2,650.00	2,650.00
Material ampullar	18,494.50	18,494.50
Material laboratorik	9,438.00	9,438.00
Material stomatologjik	1,995.00	1,995.00
Furnizim me material higjenik	1,000.00	1,000.00
Karburante për vetura	7,238.57	7,238.57
Regjistrimi I automjetit	545.00	545.00
Material Administrativ	1,280.80	1,280.80
Interneti	111.48	111.48
Sherbime kontraktuese	339.11	339.11
Ndërrimi I xhamave te autoambulancës	1,000.00	1,000.00
Avans për para të imta	2,000.00	
Karburante për nxemje qendrore	3,208.95	3,208.95

Mirmbajta e aparatit të rentgenit	4,600.00	4,600.00
Mjete mbrojtëse për Covid-19	2,160.00	2,160.00
Sherbime me aparat fotokopjues	250.45	250.45
Paga jubilare me marrveshje gjyqësore	15,989.89	15,989.89
Paga jubilare	24,374.22	24,374.22

KOMUNALI	
Rrymë elektrike	17,479.35
Shpenzimet e ujit	2,045.04
Telefon	1,096.98

Raporti i subvencioneve

Fondi burimor	Emri dhe mbiemri	Përshkrimi	Shuma
22/22200	Ngritja e përkujdesit shëndetësor	Ndihmë	4,647.21
22/22200	Ndihmë për 40 lehona	Ndihmë	6,000.00
22/22200	Ndihmë për 43 lehona	Ndihmë	6,600.00
22/22200	Ndihmë për 26 lehona	Ndihmë	3,900.00
22/22200	Ndihmë për 31 lehona	Ndihmë	4,650.00
22/22200	Ndihmë për 19 lehona	Ndihmë	2,850.00
22/22200	Ndihmë për 20 lehona	Ndihmë	3,000.00
22/22200	Ndihmë për 40 lehona	Ndihmë	6,000.00
22/22200	Ndihmë për 31 lehona	Ndihmë	4,650.00
22/22200	Ndihmë për 33 lehona	Ndihmë	4,950.00
22/22200	Ndihmë për 14 lehona	Ndihmë	2,100.00
Totali	297 kërkesa të realizuara për Lehona deri më dt.12.12.2020. Nga dt.15.12.2020 (pas mbylljes së sistemit) kemi pranu 18 kërkesa për subvencionim të Lehonave të cilat do realizohen në vitin 2021.		49,347.21

Pranimi i kërkesave:

DSHMS duke pasë parasysh situatën e krijuar nga virusi COVID 19, gjatë vitit 2020 ka pranu kërkesa të natyrës së ndryshme. Komisioni i formuar nga ZKA shqyrtoi të gjitha kërkesat e DSHMS-së dhe atë:

Kërkesa të realizuara për subvencionimin e lehonave - 297.

Kërkesa nga palët nevojtare të realizuara nga administrata e shëndetësisë dhe Qendra për Punë Sociale - 84. Vlera totale e mjeteve 70,999.21 €.

Kërkesa të realizuara nga subvencionet e Kryetarit - 5. Vlera totale e mjeteve 2,500.00€

Kërkesa të realizuara nga subvencionet e DSHPE - 47. Vlera totale e mjeteve 23,600.00 €.

DSHMS gjatë vitit 2020 realizon pagat jubilare për 44 personel shëndetësorë sipas nenit 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale nr.05-3815 e dt.12.06.2018.

Vlera totale e mjeteve është: 40,364.11 €.

Qendra Kryesore e Mjekësis Familjare

Gjatë kësaj kohe Këshilli Drejtues i QKMF-së ka vazduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, disciplinës, orarit të punës etj. Në QKMF gjatë kësaj periudhe janë trajtuar një numër i madh i pacientëve dhe janë ofruar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve (shif tabelën)

NUMRI I PACIENTËVE DHE NUMRI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Nr	QENDRA KRYESORE E MJEKËSIS FAMILJARE	Numri i patientëve	Numri i shërbimeve mjekësore
1.	QKMF OBILIQ	63133	110741
2.	QMF MILLOSHEVË	4227	10435
3.	QMF PLEMETIN	4336	8962
4.	AMF SIBOC	1923	5710
5.	AMF BREZNICË	1742	3808
6.	AMF B.MOFC	2151	8149
	TOTALI:	77 512	147 805

REFERIMET

JANAR- DHJETOR 2020

	QKMF -Obiliq		Nr. referimeve <u>PËR KONSULTI</u>	Nr. referimeve <u>NË DIAGNOSTIKËN</u>	Gjithsej Udhëzime për Kujdesin tretësor	Numri përgjithshëm i vizitave mjekësore	Përqindja e të referuarve në kujdesin tretësor
	Njësia	Departmenti	i MENË kujdesin tretësor	e kujdesit tretësor			
1	QKMF Obiliq	Mjekësi Familjare	3477	167	3644	26306	13.8%
2	QKMF Obiliq	Emergjencia	987	62	1049	9305	11.2%
3	QKMF Obiliq	Pediatria	1108	150	1258	6523	19.2%

4	QKMF Obiliq	Gjinikologjia	27	0	27	347	7.7%
5	QKMF Obiliq	Shëndeti oral	103	208	311	3033	10.2%
6	QMF Milloshevë	Mjekësi Familjare	588	68	656	3958	16.5%
7	QMF Milloshevë	Shëndeti Oral	7	109	116	664	17.4%
8	QMF Plementin	Mjekësi familjare	10	91	101	4336	5.79%
9	AMF Breznicë	Mjekësi Familjare	196	19	215	1742	12.3%
10	AMF Siboc	Mjekësi Familjare	223	38	261	1923	13.5%
11	AMF.B.Mofc	Mjekësi familjare	710	41	751	2152	34.8%
			7436	953	8389	60289	13.9%

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për Sëmundjet masive Jo infektive për periudhën JANAR-DHJETOR 2020

Të sëmundjeve masive joinfektive,

1. F00, F04, F05, F09, F20, F30, F31, F32.3, F33, F22, F29, F84, G71 (shëndetit mental)
2. E10-E14, (sëmundjes së sheqerit)
3. I00-I02, I20, I21, I24, I25 (sëmundjeve kardiovaskulare)
4. N05 (nefropatit) N03, N04, N05, N10, N18
5. J42, J45, J47, (sistemit respirator)
6. D65-D69, C-(sëmundje malinje)

Sëmundjet	Numri
I10	213
I20, I21, I24, I25	11
E10-E14	142
J42, J45, J47	16
N03, N04, N05, N10, N18	1
F00-F48	7
Sëmundjet malinje	18
Numri i refrimeve në nivelin sekondar	7436
Numri i referimeve në diagnostikë	953
Totali i pacientëve	60289

Gjatë vitit janë dorëzuar gjithësej Fletëparaqitje:

Sëmundje masovike Jo ngjitetë – 412

Sëmundje malinje – 21

Nga data 17.07.2020 kemi filluar edhe raportimin në IKSHPK, të rasteve të dyshimta me Covid 19 përmes formularëve të posaqëm nga mjekët familjar. Numri rasteve të dyshuara me Covid 19 të raportuara nga data 17.07.2020 – 31.12.2020 është 1275 pacienta.

Raportimet ditore

1. Sëmundjet e traktit Respirator	10.597
2. Sëmundjet e qarkullimit gjakut	6.161

RAPORT I NUMRIT TË PACIENTËVE SIPAS SHËRBIMIT

QKMF-OBILIQ 01.01.2020 - 31.12.2020

Njësi-QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Gjinekologja	55
Laboratori	1853
Mjekësia Familjare	17526
Pediatria	2405
Rentgen	613
Shëndeti Oral	1675
Shërbimi Emergjent	2990
Totali	27117

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA NË QKMF

DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

SEKTORI I MJEKËSISË FAMILJARE	
1.	Numri i patientëve të vizituar
	26306
	Totali i shërbimeve
	24123

KËSHILLIMORJA PËR PERSONAT ME

DIABET DHE HIPERTENSION	
1.	Nr. i pacientëve
	1286

VIZITAT SHTËPIAKE PËR NËNËN DHE FËMIUN DERI NË TRI VJET (Takime virtuale)	
1.	Nr. i vizitave në shtëpi
2.	Nr i fëmijëve të përfshirë në vizitë
3.	Nr i shtatëzënave të përfshirë në vizitë
4.	Nr i rasteve të Komunitetit Rom Ashkalinjë të përfshirë në vizitë

SEKTORI I KUJDESIT EMERGJENT

KUJDESI EMERGJENT	
1.	Numri i pacientëve të vizituar
	15460

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK

NJËSIA E SISH-IT	
1.	Numri i pacientëve të regjistruar

NJËSIA E VAKSINIMIT DHE IMUNIZIMIT	
1.	Numri i shërbimeve
2.	Numri i pacientëve në qendër dhe teren

Sëmundjet ngjitëse që janë raportuar nga ana e mjekëve familjarë në qendër dhe teren gjatë vitit 2020.

Nr	Sëmundja	Raste
1	Pneumonia	140
2	Diare	322
3	Variqellë	20
4	Dyshim në grip	277
5	Dyshim ne fruth	/
6	Dyshim ne verdhez akute	1
7	Semundjet tjera	/

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

SHËNDETI ORAL	
Numri i patientëve	3033
1. Totali i shërbimeve	10201

SEKTORI KONSULTATIV

NJËSIA E PEDIATRISË	
1.	Numri i patientëve të vizituar
	Totali i shërbimeve

NJËSIA E GJINEKOLOGjisë	
1.	Numri i patientëve
	Totali i shërbimeve

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

LABORATORI		
1.	Numri i patientëve	4153
	Totali i analizave të punuara	23478

RTG		
1.	Nr.patientëve	1658
	Totali i shërbimeve	2382

BARNATORJA NË QKMF			
	TOTALI I PACIENTËVE	7381	Fëmi:5052 Të rritur: 2329
	TOTALI I SHËRBIMEVE	11301	

MJEKËSIA FAMILJARE NË TEREN

QMF MILLOSHEVË		
1.	Numri i patientëve të vizituar	3958
	Totali i shërbimeve	9129

Shëndeti Oral – QMF Milloshevë		
1.	Numri i patientëve	664
	Totali i shërbimeve	1647

QMF PLEMETIN		
		4336

1.	Numri i pacientëve të vizituar	
	Totali i shërbimeve	10483

	AMF SIBOC	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1923
	Totali i shërbimeve	5707

	AMF BREZNICË	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1742
	Totali i shërbimeve	3698

	AMF BMOC	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2152
	Totali i shërbimeve	7910

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i administratës këtë muaj ka funksionuar pa ngecje. Në vazhdimësi është raportuar në baza ditore, javore, mujore, është mbajtur evidenca rreth vijimit të punëtorëve. Organizimi i pushimeve vjetore, përpilimi i listave të kujdestarive në vazhdimësi janë përpiluar nga Kryeshefi i Dep të MF, Shefi i Administratës në bashkëveprim me Kryeinfermierën.

TË HYRAT NGA PARTICIPIMI

Data e dorrëzimit	Shuma	Vendi ku janë dorrëzuar
TOTALI	14907.4 E	NLB

RAPORT I KARBURANTEVE

	Benzin	Dizell
RAPORT VJETOR		10131.83 litra

Njësia për shërbime teknike

Sa i përket furnizimit me material higjenik ka qenë në nivel. Higjiena ka qenë në nivel të duhurme vërejtje të kohëpasëkohëshme.

Barnatorja qëndrore

Furnizimi me barëra brenda këti viti ka qenë i kënaqëshëm. Barërat që kanë arritur në barnatore janë shpërndar vazhdimesht nëpër QMF dhe AMF. Kërkosat për barëra nga lista esenciale janë dorëzuar në Korporatë me rregull. Furnizimi me insulinë ka qenë në nivel gjatë vitit 2020.

ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (ZHVP)

Në QKMF në kuadër të ZHVP-së u mbajtën 11 ligjérata për Mjekë si dhe 10 ligjérata për Infermier, ndërsa jashtë Qendrës 77 Mjek dhe 39 Infermier vijuan trajnime dhe takime.

Edukimi dhe promovimi shëndetësor

Në fshatin Breznicë, Milloshevë dhe Siboc grupi i Edukit dhe promovimit shëndetësor mbajtën nga 3 ligjerata për qytetar me tema: Hipertensioni arterial, Higjena orale Vaksinimi & gripi sezonal, coronavirusi, Edukimi si dhe trajtimi i qytetarëve gjatë pandemisë COVID 19 përmes platformës “on line” (linja telefonike pa pagesë, viber, Web faqeve ,etj)

Numri i personave të infektuar me virus COVID-19, në komunën e Obiliqit është 783 pacientë, të shëruar nga virusi COVID 19 gjatë vitit 2020 janë 686 persona. Prej tyre raste të vdekjes nga COVID-19 janë gjithsejt 28 pacientë. Pacientë të dyshuar dhe testuar janë 1626.

Masat e ndërmara në këtë periudhë janë:

- Zbatimi i të gjitha masave dhe rekomandimeve nga MSH, IKSHPK, OSH, UNICEF, etj
- Përkuqdesja shëndetësore ndaj personave të prekur me COVID 19 e po ashtu edhe shpërndarja e barnave në shtëpi.
- Furnizimi me aparaturë si dhe servisimet e vazhdueshme.
- Furnizimi i vazhueshëm me oksigjen, barëra, paisja me aparaturë oksigjeno-prodhues si dhe me mjete mbrojtëse (dorëza, maska, dezinfektues, uniforma).
- Mbulimi i pikave të ajroportit dhe atyre kufitare me ekipe mjekësore mbështetëse.
- Është bërë dezinfektimi i objekteve shëndetësore vazhdimisht.
- Bashkëpunimi ndërsektorial në nivel komunal si dhe me nivelin qendrorë në menaxhimin e COVID – 19.
- Aplikimi i testeve serologjike për diagnostifikim të popullatës
- Përfundimi i fazës pregaditore rrëth vaksinimit të popullatës me vaksinën anti COVID 19

Sfidat në parandalimin e pandemisë COVID-19

- Mos zbatimi në tërësi i rekomandimeve dhe udhëzuesve për parandalimin e COVID19 nga qytetarët.
- Frekuentimi i madh i qytetarëve nga Komunat e tjera
- Gjendja socio-ekonomike e popullatës.
- Refuzimi eventual i vaksinës anti COVID 19 nga popullata.

Qendra për Punë Sociale

Skema e Ndihmës Sociale

Skema e Ndihmës Sociale në Obiliq është ngritur në vitin 2000, është një mbështetje dhe ofrim i ndihmës së përkohshme financiare për familjet në varfëri. Kjo ndihmë e përkohshme financiare u ofrohet familjeve të cilat plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuar me Ligjin Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, një numri të caktuar të udhëzimeve administrative dhe në bazë të buxhetit vjetor që Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë për këtë skemë.

Ofrimi i Ndihmës Sociale gjatë periudhës 12 mujore Janar- Dhjetor për vitin 2020, Sipas kushteve dhe kritereve që parashihen me aktet ligjor dhe nënligjore të Skemës së Ndihmave Sociale.

Ndihmen Sociale për periudhën raportuese e kanë realizuar numri i familjeve si më poshtë:

Numri I famljeve dhe antarëve të familjes së SNS-së sipas muajeve Janar- Dhjetor për vitin 2020

Muajt	Nr.i familjeve në SNS	Antarët e familjes në SNS	Shuma në €
Janar	768	3,185	82,807.50 €
Shkurt	773	3,196	83,977.50 €
Mars	766	3,152	164,157.50 €
Prill	771	3,141	165,680.00 €
Maj	792	3,257	172,512.50 €
Qershor	777	3,213	84,617.50 €
Korrik	771	3,180	83,740.00 €
Gusht	777	3,196	84,925.00 €
Shtator	775	3,195	84,667.50 €
Tetor	791	3,255	170,207.00 €
Nentor	814	3,351	176,572.50 €
Dhjetor	821	3,387	176,557.50 €
Gjithesejt:			1,530,421.00 €

Gjatë këtij 12 mujori Janar - Dhjetor kemi këto: Aplikime, Riaplikime, Riaktivizime dhe Ndërprerje.

Muajt	Aplikime	Riaplikime	Riaktivizime	Ndërprerje
Janar	4	93	2	7
Shkurt	3	113	4	12
Mars	4	127	1	7
Prill	0	115	3	4
Maj	0	97	3	3
Qershor	0	73	0	11
Korrik	2	70	1	9
Gusht	7	74	5	6
Shtator	7	70	5	7
Tetor	7	86	9	9
Nentor	8	112	7	5

Dhjetor	4	95	5	5
---------	---	----	---	---

Lëndët e Komisionit Mjekësor për muajt Janar - Dhjetor 2020

	Lëndët e Aprovuara nga K.Mjekësor	Lëndët e refuzuara nga K.Mjekësor	Gjithësejt:
Janar	40	0	40
Shkurt	41	1	42
Mars	41	0	41
Prill	/	/	42
Maj	/	/	40
Qershor	/	/	47
Korrik	/	/	39
Gusht	5	0	5
Shtator	12	2	14
Tetor	51	2	53
Nentor	18	1	19
Dhjetor	4	1	5

-Organizata Human Apple -INT në bashkëpunim me QPS-në në Obiliq gjatë muajit janar 2020 ka shpërnda për 32 familje nga 3 metra dru dhe nga dy batanije. Përsitues janë rastet sociale në varfëri të skajshme.

-Raste të atakuara gjatë muajit janar 2020 janë tri raste.

-Raste të atakuara gjatë muajit shkurt 2020 janë tri raste.

-Në bashkëpunim me MPMS - Departamentin e Ndihmave Sociale në Prishtinë janë shpërnda veshëmbathje për 70 familje. Përsitues janë rastet sociale në varfëri të skajshme.

-Një donacion nga Organizata e Emirateve të Bashkuara në bashkëpunim me MPMS- Departamentin e Ndihmave Sociale në Prishtinë janë shpërnda pako ushqimore dhe miell për familjet skamnore, 150 familje gjithësejt. Me nga 2 pako ushqimore dhe 50 kg miell u ndihmuani 11 familje të komunitetit Rom të cilat nuk kan përfitën SNS për muajin prill 2020 nga fshati Plemetin.

-Një donator ndihmon 6 familje me pako ushqimore ne vler prej 30 €.

- Qendra Sociale përmes UNDP-së, ndihmon 77 raste të rënda sociale me pako ushqimore.

- U ndihmuani 60 familje me nga tre kupona për muajt gusht, shtator dhe tetor në vler prej 70 €.

- Shoqata bamirëse "Jetimat e Ballkanit" ndihmuani 250 familje me pako të mishit.

- UNICEF ndihmon me mjete didaktike 83 familje, konkretisht fëmijët e moshës 2 deri 5 vjeç.

Raport i Shërbimeve Sociale dhe Familjare për vitin 2020

Gjatë vitit 2020 në shërbimet sociale dhe familjare janë paraqitur gjithësej 266 raste

1. Fëmij pa kujdes prindor - 13
2. Strehim familjar te të afërmít - 11
3. Kërkesa për adoptim vendor - 9
4. Kërkesa për adoptim ndërkombëtar - 0
5. Fëmij I keqtrajtuar - 8
6. Fëmij me sjellje asociale- 8
7. Përdoruesit e substancave narkotike- Nuk ka të dhëna

8. Puna e rrezikshme -9
 9. Rrëmbim ndërkombëtar i fëmijëve 0
 10. Të miturit në konflikt me ligjin - 14
 11. Viktimat e dhunes në familje - 9
 12. Viktimat e trafikimit- 16 (Viktima e trafikimit po konsidrohen edhe rastet që detyrohen për lypsari).
 13. Viktima e krimeve seksuale -0
 14. Martesa e të miturëve - 1
 15. Këshilla martesore (Divorc) - 18
 16. Të moshuarit - 0
 17. Klient të tjerë:
 - A. Me probleme familjare - 23
 - B.Nënët vetëushqyese -7
 - C. Personat me aftësi të kufizuar - 2
 - D.Fëmijë me aftësi të kufizuar - 8
 - E. Aftësia e prindërve nuk është adekuate për përkujdesje ndaj fëmijës – Nuk ka kërkesa
 - F/1. Vërtetim për armëmbajtje - 35
 - F/2. Vërtetim për punësim - 48
 - F/3. Vërtetim për SNS -13
 - F/4. Vërtetim për humbje të shtetësisë - 49
 - G. Nëna e cila potencialisht do të braktisë fëmijën e saj - 1
 - H. Nëna e cila e ka braktisur fëmijën e saj -1
 - I.Babai i cili ka braktise fëmijën e tij -0
 - J.Registrimi i më vonshëm I fëmijëve - 0
 - K. Arsyje tjetër - 0
-
18. Njoftime nga emaill për trajnime, seminare, konferenca permes platformës zoom- 40
 19. Raporte bashkëpunuese me OJQ - 9
 20. Shkresa administrative - 8

Lidhur me ofrimin e Shërbimeve sociale janë ofruar 489 aktivitete të ndryshme të kategorive sociale si: **vizita në shtëpi, intervista, intervenime dhe bashkëpunim ndërinstitucional.** Gjatë gjithë vitit kemi pasur bashkëpunim të ndërsjellt me Organizata Qeveritare dhe jo Qeveritare, si OFAP-i, UNICEF-i, KOMF, SOS- Fshati, bashkëpunim me MPMS-në, Komunën, Shtëpinë strehuese në Prishtinë, Policinë e Kosovës, Gjykatat etj.

Gjatë gjithë vitit 2020 stafi i Shërbimeve Sociale nuk ka ndërpren ofrimin e shërbimeve sociale për banorët e Komunës së Obiliqit. Gjatë muajve mars-prill nuk kishte trend të ngritjes së dhunës në familje megjithatë pëntorët kanë mbajtur kujdestarinë 24 orë.

Shtëpia e pleqëve:

Me qëllim të menaxhimit të situatës dhe rrezikut të mundshëm nga Corona Virusi më 11.03.2020 në Komunën e Obiliqit mbylljet përkohësisht "Shtëpia e Pleqëve" si rezultat i rrezikshmërisë më të lartë që të moshuarit të atakohen nga Virusi COVID 19.

Pas mbylljes së aktiviteteve në "Shtëpinë së Pleqëve" ky objekt caktohet si karantinë për rastet në nevojë të infektuara me COVID-19

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020 - DREJTORIA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

Aktivitete të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të drejtore:

1. **Monitorimi i gjendjes mjedisore:** ajrit, ujtit, tokës dhe zhurmës përmes raporteve mujore nga TC-A, TC-B, Divizionit të Qymyrit dhe raportit të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK), dhe monitori i vodusur në qendër të Obiliqit (sheshi AzizZhilivoda)
2. **Pastrimi dhe larja e trotuareve dhe rrugëve – plani i punës me kompaninë “Pastrimi”;** Rrugët e kategorisë së parë (zona e parë) një herë në javë, rrugët e kategorisë së dytë dy herë në muaj dhe sipas kërkesave të DMM-së.
3. **Mirëmbajtja e shesheve dhe parqeve – kontrata “Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave gjelbëruese(kontrata tri vjeçare Mirëmbajtja e parqeve punohet në baza ditore për çdo ditë ndërsa në pllakat përkujtimore tri herë në vit dhe sipas kërkesë së DMM-së).**
4. **Aktivitete ditore në vendbanimet që janë të përfshirë në bartjen dhe grumbullim të mbeturinave komunale – kontrata me kompaninë “Pastrimi” dhe monitorim i vazhdueshëm nga DMM gjatë procesit të marrjes dhe largimit të mbeturinave**
Mënyra e shërbimit të organizuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është i organizuar në formën e bazuar të zonave të banimit brenda komunës. Shpeshtimi i grumbullimit, numri dhe lloji i kontejnerëve është i definuar për tre sektor të banimit:

1. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit kolektiv dhe qendra e qytetit bëhet për çdo ditë;
2. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit individual brenda qytetit bëhet tri herë në javë;
3. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga Sektori i vendbaneimeve në zonat rurale në kuadër të komunës bëhet një herë në javë.

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës, në disponim i ka dy kamion (dhe i kryen nga dy udhëtime me kamionë special).

1. Inspektimi i mbeturinave, respektimin e ligjit dhe udhëzimeve për mbeturinat, transporti i tyre e të ngjashme, inspektimi në biznese,

Në kuadër të kompetencave të Ligjit për mbeturina dhe planit për kontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, përmes inspektorit dhe zyrtarëve komunal mjedisor ka realizuar inspektimë(kontrollë)të vazhdueshme për të gjithë ata që kanë vepruar në kundërshtim me udhëzimet dhe Ligjet Mjedisore duke u nisur nga Operatorët Ekonomik (OE), që veprojnë në territorin e Obiliqit, mbeturinat, hedhjen e dheut si dhe kamionëve për bartjen e mbeturinave komunale në Deponinë në Mirash. Në vendin e ngjarjes u bënë procesverbale, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin për mbeturina, dhe u shqiptuan edhe gjoba.

2. Shënimet e ditëve Mjedisore – Duke pas parasysh që viti 2020 ka qenë vit në të cilin është përhapur pandemia Covid-19, kjo ka ndikuar edhe në aktivitetet mjedisore ku prej shumë aktiviteteve të parapara janë zhvilluar vetëm aktivitetet në tre mujorin e parë të vitit 2020.

Projektet dhe detyrat që janë realizuar këtë vit:

- Rregullimi i parqeve në Obiliq; Parku në Mazgit te Lapidari “Ferid Curri” Parku në fshatin Plementin dhe Parku te ish-restauranti i KEK-ut/
- Pastrimi i deponive ilegale me këto lokacione: Largimi i mbeturinaveështë bërë në territorin Obiliqit duke filluar nga Qyteti e Obiliqit me fshatra. Gjithsej janë larguar mbi 34deponi ilegale me mbeturina.
- **Furnizimi me Kontejner** - DMM ka bërë blerjen e 500kontejnerëve 120L ku shpërndarja e tyre është bërë te ekonomitë familjare te cilat nuk kanë qenë nëshërbimetëmarrjes se mbeturinave
- **Takime dhe inspektimi me Inspektoratin mjedisor të MMPH,**

Inspektimi të përbashkëta në KEK, Deponia në Mirash, Hekurishtë, Fabrika e blokave në Llazarevë dhe OE te të cilët kanë pasur ndikim në mjedis.

- **Inspektimi Deponisë Sanitare Mirash, qëllimi dhe rezultati.**

Në kuadër të mbikëqyrjes të aktiviteteve, përputhshmërinë e aktiviteteve me standartet dhe normat ligjore përmbrrojtje të mjedisit, është bërë kontrolli në Deponinë Rajonale Mirash, zyrtarët mjedisor në bazë të kompetencave kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe konstatojmë se gjendja në deponi kahasuar me vitet e mëparshëm është dukshëm më e mirë, mirëpo prapë janë dhënë vërejtje që të punohet në bazë të planit operativ ditor si në kompaktin, mbulim, shtresim dhe si problem tjetër ishin qentë endacak, shpezët, insektet dhe minjtë për çka kemi kërkuar që për shkak të sezonës verore të bëhet dezinsektimi i deponisë.

Inspektimi dhe kontroll të autotransportuesve për bartjen e mbeturinave;

- Në kuadër të kompetencave të Ligjit përmbrrojtura dhe planit përkontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria përmbrrojtjen e Mjedisit, përmes inspektoret dhe zyrtarëve komunal mjedisor ka realizuar kontroll të vazhdueshme kamionëve përbartjen e mbeturinave komunale në Deponinë regionale sanitare në Mirash. Inspektimi është bërë me Inspektoret komunal dhe u asistua nga Policia e Kosovës, gjegjësisht Stacioni Policor në Obiliq. Aktiviteti i inspektimit u përqendrua në rrugën Dardhishtë - Mirash, dhe në fillim të rrugës "Hasan Prishtina" përkatësisht tek rrithi në Shkabaj. Gjatë kësaj periudhe u ndaluan të gjitha automjetet transportuese që bartnin mbeturina komunale. Në vendin e ngjarjes u bënë procesverbale, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin përmbrrojtura si dhe u shqiptuan gjoba.

Pjesëmarrje në garën "Mjedis i Pastër" projekt në të cilin kemi fituar 95.000.00€.

Inspektimi te të gjithë operatorëve që veprojnë në territorin e Obiliqit – raporti dhe plani i veprimit:

- DMM ka hartuar planin përkontroll dhe inspektim përmbrrojtës që veprojnë në Obiliq, prandaj gjatë këtij viti janë shqiptuar dhjetë (10) gjoba dhe janë plotësuar 59 procesverbale.

Mbikëqyrje të kryerjes së punëve në projekte:

1. Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara,
2. Zëvendësimi i drunjve dekorativ,
3. Furnizimi me kontejner,
4. Rregullimi i parqeve.

Gjatë kësaj periudhe kohore, inspektorët mjedisor kanë kryer gjithsej:

- 59 kontrollime të ndryshme Rutinore- të planifikuar, (plani)
- 33 vërejtje verbale
- 68 inspektimi – sipas kërkesave të qytetarëve (loji inspektimit).

Janë shqyrtuar 70 kërkesa të qytetarëve, gjithashtu janë lëshuar edhe 10 Leje Mjedisore duke mbledhur të hyra në vlerë: 7,945.99 €, ndërsa duke respektuar UA përmbrrojtja Gjobat Mandatore kemi shqiptuar apesë (5) gjoba duke arritur të mbledhim të hyra në vlerë 500.00€.

Kemi marrë pjesë në grupet punuese të cilat përbëhen nga Banka Botërore, KEK dhe instancat tjera lidhur me planifikimet përmbrrojtje investime në pjesë tek Kosova A përkatësisht tek deponia e hirit. Gjithashtu zyrtarët e DMM-së kanë qenë të angazhuar edhe me projekte të drejtoreve tjera, duke bërë vlerësim, menaxhim, pranim teknik etj.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020 - DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencapromovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të shërbimeve publike dhe kryen koordinimin e aktiviteteve të tjera ditore, javore dhe mujore.

Prioritet për vitin 2020

Prioriteti- 1. Ofrimi i shërbimeve komunale sa më cilësore për qytetarët e komunës.

Prioriteti- 2. Shtrirja dhe mirëmbajtja e ndriçimit Publike në qytet dhe fshatra

Prioriteti- 3. Trajtimi i ujërave të zeza fekale dhe atmosferike nëpër fshatra.

Prioriteti- 4. Trajtimi i ujërave të zeza-urbane.

Prioriteti- 5. Trajtimi i hapësirave publike në qytet.

Prioriteti- 6. Ofrimi i shërbimeve publike sa më cilësore.

Prioriteti -7. Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal në territorin e Komunës sonë.

Prioriteti- 8. Investime publike në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Aktivitetet për vitin 2020

- Menaxhimi i situatave emergjente.
- Menaxhimi i Situatës me COVID-19, shpërndarja e pakove ushqimore
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe pastrimi i tyre gjate dimrit.
- Përgatitja e stafit dhe dokumenteve bazë për fatkeqësi natyrore dhe rreziqe tjera.
- Mirëmbajtja dhe deblokomë i kanalizimeve.
- Mirëmbajtja e ndriçimit Publik.
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal.
- Shtrimi dhe mirëmbajta e rrugëve të rendit të -IV.
- Shërbimin e sigurimit të objektit të Kuvendit Komunal.

Aktivitet tjerë të DSHPE-së

Kemi pranuar 412, kërkesa të ndryshme nga qytetaret, ku janë shqyrtuar 410, të miratuara 257, të refuzuar 153, të anuluara 1, të hedhura poshtë 1. Duke u bazuar në Kushtet Ndërtimore nga DPUPK-Obiliq janë lëshuar 8, Pëlqime-parimore për kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe në rrjetin elektrik të qytetit dhe 10 pëlqime tjera të natyrave të ndryshme.

Deri me tani kemi trajtuar 372, raste të intervenimit në deblokim të rrjetit të kanalizimit nëpër qytet dhe fshatra të territorit të komunës sonë. (në bashkëpunim me kompaninë publike KUR-Prishtina njësia në Obiliq).

DSHPE me kompaninë e kontraktuar dhe në bashkëpunim me KEDS-in kemi bërë edhe dislokimin e trafosnë lagjen Retkoceret rr:Hasan Prishtina- Obiliq dhe kemi vendosur trafo të re,gjithashtu në bashkëpunim me KEDS-in kemi bërë edhe dislokimin e shtyllave elektrike sipas nevojave të paraqitura në teren si në rastin e ndërtimit të Çerdhes, parqeve apo rrugëve të ndryshme.

DSHPE bazuar në Vendimin për Leje Rrenim nga DPUPK me nr.V-256 dt.10.03.2020 ku janë paraparë të rrënohen objektet me destinim të ndryshëm në parcelat: 647-24, 664-0, 1448-5, 1448-1, 1448-6, 1448-2, 1448-3, 1448-4, ka përcjellë punimet e rrënimit (ka bërë sigurimin) dhe ka mbikëqyrur punët e kompanisë së kontraktuar nga komuna-DSHPE gjatë rrënimit, poashtu edhe gjatë rrënimit të objektit të vjeter para shtëpisë së kultures DSHPE ka kryer punët dhe detyrat e saj.

DSHPE ka raportuar në AEE në kuadër të MZHE përmes pyetësorit për masat eficiente të cilat i keni marruar gjatë vitit 2020, (në institucionet komunale). Plotësimi i këtij pyetësori është obligativ sipas Ligjit Nr. 06/L -079, për Eficiencë të Energjisë.

DSHPE në bashkëpunim me MMPH është duke punuar në projektin WBIF "Vlerësimi paraprak i rrezikut nga vërshimet në pellgun e Lumin Sitnicë" që zbatohet nga IPFB(COWI IPF) për zonat e propozuara të rreziqeve të mundshme nga vërshimet.

Në kuadër të drejtorisë DSHPE është përgatitur:

- **"Rregullorja për Varreza, ofrimin e shërbimit të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre"** si dhe
- **"Rregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronë publike"** këto Rregullore për shkak të COVIDIT-19, nuk janë proceduar në Kuvendin komunal e që shpejt do të procedohen për ligjshmëri pran Kuvendit komunal.

Më poshtë kemi renditur projektet që kanë përfunduar dhe projektet që janë vazhdimësi e viteve paraprake dhe që do jenë vazhdimësi në vitin 2021

1. **Projekti:** "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal." është në fazën e punimeve dhe është kontratë kornizë.
2. **Projekti:** "Sistemi Solar Fotovoltik "Komuna e Obiliqit" 15.81 kWp (panele solare) është përfunduar dhe është pajisur me pëlqim nga ZRRE dhe KEDS-i.
3. **Projekti:** "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve" të qytetit ka përfunduar me sukses
4. **Projekti:** "Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Obiliq" është kontratë kornizë 2020-2022, projekti është në vazhdimësi duke u realizuar.
5. **Projekti:** "Rregullimi i varrezave dhe mirëmbajtja" ka përfunduar gjatë vitit 2020 ku janë pastruar mbi 151.000 metra katror të varrezave dhe janë rrethuar me rrethoj varrezat e fshatit Raskovë.
6. **Projekti:** "Shtruarja e rrugëve me zhavor" është kontratë kornizë dhe është në vazhdimësi të realizimit
7. **Projekti:** "Shtrirja e Ndriçimi publik" është projekt i përfunduar me sukses.
8. **Projekti:** "Ndërtimi i objekteve dhe renovimi i hapësirave për komunitete" në kuadër të kësaj vije buxhetore është realizuar projekti i "Ndërtimi i Tregut në Obiliq".
9. **Projekti:** "Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për raste sociale" kjo vijë buxhetore është bartur tek vija e bashkëfinancimit me që rast me Shoqatën Jetimat e Ballkanit është lidhur memorandum bashkëpunimi për ndërtimin e 20 shtëpive për familjet në nevojë

10. Projekti: "Blerja e veturave" është kontratë që ka përfunduar me sukses.
11. Projekti: "Renovimi i ndërtesave sociale" është projekt që do vazhdojë realizimi edhe në vitin 2021
12. Projekti: "Digitalizimi i rrugëve dhe objekteve publike në Obiliq" është projekt që ka përfunduar me sukses.
13. Projekti: "Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik" është projekt në vazhdimësi nga viti 2019 dhe do vazhdoj edhe vitin 2021.
14. Projekti: "Ndërtimi i minares së Xhamisë në Breznic" është projekt që ka përfunduar me sukses.
15. Projekti: "Sigurimi fizik i objektit të Komunës" është kontratë vazhdimësi e viteve paraprake dhe do të vazhdon edhe vitin 2021.

Më poshtë paraqesim në mënyrë tabelare rastet emergjente në të cilat janë evidentuar nga ana e drejtorisë dhe inspektimet e kryera nga ana e drejtorisë.

Inspektimet nga lëmia e MNZ-së (mbrojtjes nga zjarri) për vitin 2020						
Nr.	Përshkrimi	Subjekti	Vendi	Data e inspektimit	Shoqërore	Private
1.	Inspektim fillestar	Banka ekonomike	Obiliq	15.10.2020		Private
2.	Inspektim fillestar	Finca	Obiliq	15.10.2020		Private
3.	Inspektim fillestar	Kreditimi rural i Kosovës	Obiliq	15.10.2020		Private
4.	Inspektim fillestar	IMF KEP	Obiliq	15.10.2020		Private
5.	Inspektim i rregullt	KUR Prishtina	Obiliq	17.12.2020	Shoqërore	Private
6.	Inspektim i rregullt	NLB Banka	Obiliq	17.12.2020		Private
7.	Inspektim i rregullt	RBKO-Raiffeisen bank	Obiliq	17.12.2020		Private

Inspektimet nga lëmia e MNZ-së:

1. Inspektime fillestare: 4
2. Inspektime të rregullta :3
3. Inspektime sipas pronësisë: a) Shoqërore.....1 b) Private..... 6

Rastet e zjarreve gjatë vitit 2020 në vendbanime të komunës së Obiliqit				
Nr.	Vendi	Data	Pronësia	Dëmet
1.	Obiliq	11.02.2020	Private	Djegie e veturës Golf 2
2.	Breznice	24.02.2020	Private	Djegie e pemishtes (lajthi)
3.	Palaj	12.04.2020	Private	Djegie disa trarëve të kulmit-shtëpi e vjetër e pabanueshme
4.	Janivodë	15.04.2020	Private	Djegie e një pjesë të kulmit-shtëpi e vjetër e pabanueshme
5.	Obiliq	20.04.2020	Private	Djegie e tërësishme e shtëpisë një katëshe -e banueshme
6.	Plemetin	14.05.2020	Private	Djegie e disa gjërave brenda shtëpisë së banueshme
7.	Llazarevë	14.06.2020	Private	Djegie e gjërave ushqimore në market
8.	Shkabaj	1.08.2020	Private	Djegie e pirunarat, 7 ballove të letrës për riciklim, disa paneleve të kulmit të ndërtësës ,një pjesë e mbulojës së rimorkios së kamionit të kontraktuar
9.	Dardhishtë	13.08.2020	Private	Djegie e disa gjësendeve të vjetra në shtëpi të pabanueshëm
10.	Shkabaj	14.09.2020	Private	Djegie e pajisjeve ne kuzhinën e restorantit

11.	Obiliq	10.11.2020	Private	Djege e shtëpisë-pjesërisht kulmi, instalimi elektrik dhe një pjesë e tavanit
-----	--------	------------	---------	---

Gjatë vitit vitit 2020 kemi gjithsejt 11 raste të zjarreve
Sipas pronësisë:

- a. Shoqërore:Nuk ka
- b. Private:11
- c. Shpenzimet e derivateve gjatë vitit 2020

Shpenzimet e naftës të veturave për vitin 2020			
Nr	Muaji	Litra	Vleranë euro
1	Janar	980.09	918.64
2	Shkurt	946.11	834.66
3	Mars	965.36	710.70
4	Prill	1,191.00	766.12
5	Maj	1,136.98	762.80
6	Qershor	1,414.11	1,028.06
7	Korrik	1,406.11	1,056.27
8	Gusht	1,619.71	1,197.45
9	Shtator	1,423.39	1,008.33
10	Tetor	1,434.09	1,022.65
11	Nëntor	1328.16	958.06
12	Dhjetor	1559.41	1247.68
	Total	15404.52	11511.42

Shpenzimet e benzinës të veturave për vitin 2020			
Nr	Muaji	Litra	Vleranë euro
1	Janar	109.81	100.45
2	Shkurt	173.54	153.29
3	Mars	74	50.83
4	Prill	113.03	68.78
5	Maj	73.01	49.12
6	Qershor	150.03	110.44
7	Korrik	94.02	70.65
8	Gusht	151	113.79
9	Shtator	187.02	140.99
10	Tetor	790.02	563.36
11	Nëntor	67.65	49.72
12	Dhjetor	217.02	167.67
	Total	2200.15	1639.09

Shpenzimet e naftësë Minibusave për vitin 2020			
Nr	Muaji	Litra	Vleranë euro
1	Janar	443.00	415.22
2	Shkurt	542.03	478.18
3	Mars	301.02	221.61
4	Prill	0.00	0.00
5	Maj	0.00	0.00
6	Qershor	77.00	55.98
7	Korrik	0.00	0.00
8	Gusht	0.00	0.00
9	Shtator	428.00	303.20
10	Tetor	67.78	50.12
11	Nëntor	633.08	470.43
12	Dhjetor	550.02	440.07
	Total	3041.93	2434.81

Gjeneratori gjatë vitit 2020 -356 Litra=274.76 €

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020 - DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Drejtoria e Inspektionit, gjatë kësaj periudhe ka punuar me plan- programin e punës për këtë vit duke u bazuar në kompetencat të cilat janë derivat i Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative, Rregullorev Komunale.Për këtë periudhë kemi kryer punë të përditshme që e karakterizojnë këtë drejtori.

Vërehet një ngritje e dukshme e kapaciteteve të punës në të gjitha inspektimet krahasuar me periudhën e njëjtë të viteve paraprake.

Prioritet gjatë kësaj periudhe kohore i kemi dhënë:

- Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik (ZIVE)
- Parandalimi COVID 19
- Pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve
- Inspektimit në fushën e ndërtimit
- Inspektimeve në komunikacionin rrugor
- Inspektimeve në lëmin e tregut
- Inspektimeve në sanitari etj

Raporti i punës së Drejtorisë së Inspektionit është i përgatitur për secilin inspektorë veq e veq, ndërsa në vijim më në detaje janë të pasqyruara në formë tabelare dhe me përshtrim inspektimet për secilën lëmi.

Raporti i përgjithshëm një vjeçar i punës për vitin 2020 në formë tabelare:

Janar - Dhjetor 2020	
Numri i inspektimeve me Procesverbal	580
Kërkesa për t'u pajisur me Pëlqim për kushte higjeno-sanitare	93
Aktvendim /ndalim të punimeve /rrënim /pano /gjoba	85
Urdhër ekzekutimi për rrënim	5
Gjoba mandatore	51
Kërkesë për Gjykatë	1
Lëndë të proceduara te Përbaruesi	5
Vendim për izolim COVID 19	786
Vendim për shfuqizim COVID 19	786
Kërkesa nga qytitarët	129
Inspektim i përbashkët me Policinë e Kosovës	475
Kërkesë për asistencë - S.P.Obiliq	2

INSPEKTORI I TREGUT

Nr.	Raporti i punës - Inspektori i Tregut	Gjithësejt	Vrejtje

1	Numri i inspektimeve të përgjithëshme	1486	
2	Inspektime me procesëverbal	205	
3	Numri i inspektimeve - lokaleve ushqimore dhe tregtare	236	
4	Numri i inspektimeve - lokaleve hoteliere	159	
5	Numri i inspektimeve - pompare të benzines	18	
6	Numri i inspektimeve të Barnatoreve	18	
7	Numri i inspektimeve në Ordinanca	10	
8	Numri i inspektimeve në Sallone Ondulimi	18	
9	Numri i inspektimeve në fabrikën për përpunimin e mishit	4	
10	Inspektim i përbashkët me inspektor të MTI	7	
11	Aktvendime - Gjoba mandatore	7	3350.00 €
12	Inspektime me Inspektoret e AUV-it	264	
13	Numri i kërkesave nga palët	55	
14	Pranim me komision për Pëlqim - pranim për plotsimin e kushteve higjenosanitare	47- 2Refuzime	2115.00 €
15	Asgjasim i mallit me afat të skaduar	3	
16	Shoqërim inspektorëve tjera	324	
17	Asgjasim I mallit	2	40+20=60 €
18	Inspektim i përbashkët me Policinë e Kosovës	175	

Gjatë kësaj periudhe kohore të inspektimit si prioritet kemi pasur:

- Regjistrimin e bizneseve të reja.
- Vendosjen e çmimeve dhe të orarit të punës.
- Kontrollimin e dhenies së faturave shitëse e, blerësve-konsumatorëve.
- Kontrollimin e deklaracionit të mallit-kualitetin, shërbimet.
- Kontrollimi i te gjitha subjekteve afariste që bëjn transportimin e mallrave nga subjekti te subjekti tjeter, kontrollimi i dokumentacionit perçellës.

- Inspektimi i kushteve teknike te subjekteve afariste tregtare që merren me shumic dhe pakic , dhe subjektet sherbyse etj.
- Kontrollimi i peshojave (kalibrimi i tyre).
- Bashkepunimi me inspektoratet qendrore dhe ndërkommunale si dhe me Policin e Kosovës.
- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave eventuale.
- Inspektime për parandalimin dhe luftimin e smundjeve ngjithëse COVID-19 duk u bazuar ne vendimet e qeverisë dhe ligjin për covid-19 .

INSPEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Nr.	Raporti Vjetor i Punës 2020	Gjithsej	Emri Palës
1	Inspektime të përgjithshme	1450	
2	Inspektime me procesverbal	245	
3	Inspektime në Transportues	28	
4	Kërkesa nga palët	15	
5	Thirrje për palë	3	
6	Pranime me Komision	48	
7	Aktvendime	29	
8	Aktvendime Për pano	26	
9	Lëndë të proceduara përmbarim	5	
10	Gjoba Mandatorë	23	
11	Lëndë për Gjykatë	1	
12	Asgjësimë të produkteve	4	
13	Inspektime të ndryshme- Komunale	17	
14	Inspektime në lëmin e Sanitaris	90	
15	Kërkesë për polici	2	
16	Inspektime në Hoteliere	49	
17	Inspektime në Ushqimore	35	
18	Monitorim i Vorrimeve me Covid-19	29	
19	Vendime për Izolim	786	
20	Shfujizime të vendimeve për Izolim	786	
21	Inspektime në Barnatore	18	
22	Inspektime në Sallone Ondulimi	15	

22	Inspektime në Shkolla	17	
23	Zhvarrim-Exsumim	4	
24	Pranime me Ministri	4	
25	Inspektime me Inspektoret tjerë	568	

Inspektori i Komunikacionit gjatë këtij viti kalendarik Sipas planit të punës, jemi përkushtuar ti kryejmë të gjitha punët të cilat na obligon vendi i punës ti zbatojmë Ligjet dhe Rregulloret në fuqi s'i, Ligjin Nr. 04/L-179 Për Transportin Rugor, Ligjin Nr. 2003/11 Ligji për Rugët dhe Rregulloren Komunale për Transportin Rugor në Territorin e Komunës së Obiliqit. Nr.-I-117. Si dhe të gjitha urdhëresat e dhëna nga Drejtori dhe Shefi.

